



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

RREGULLORE

MBI

“E drejta për hyrje në të dhënat mikro”

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje.....	3
I. Të dhëna mikro të anonimizuara	4
II. Të dhëna mikro të anonimizuara me të drejtë hyrje me kërkesë	6
Rregullat mbi të drejtën e hyrjes në të dhënat mikro me kërkesë.....	6
Informacion i përgjithshëm.....	6
Baza ligjore.....	7
Procedura e aplikimit	8
Konfidencialiteti	8
Kriteret për të drejta për hyrje në të dhënat mikro	8
Grupet e caktuara me të drejtë hyrje:	9
Infrastruktura IT për të drejtën e hyrjes në të dhënat mikro	9
Siguria në ambientin e INSTAT.....	10
Mbrojtja e produktit statistikor	11
Kontrolli.....	11
Mirënjohje.....	12
Sanksionet.....	12
Minimizimi i të dhënave.....	12
Procedura e aplikimit për skedarët me të dhëna mikro me kërkesë	12
Aneks 1 - Forma e aplikimit për skedarët me të dhëna mikro.....	14
Aneks 2 - Deklaratë konfidencialiteti për punonjësit e INSTAT	19
Aneks 3 – Deklaratë konfidencialiteti për përdoruesit	20
Aneks 4 - Kontratë ndërmjet palëve	21
Lista e Vrojtimeve	23

Hyrje

Instituti i Statistikave referuar në vazhdim si INSTAT, si institucioni zyrtar për prodhimin e statistikave zyrtare në vend, ka për mision të prodhojë statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuar, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit dhe të transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Në zbatim të këtij misioni, INSTAT synon t'u përgjigjet kërkesave gjithnjë në rritje të përdoruesve për vendimmarrje dhe kërkime shkencore, duke shpërndarë informacionin statistikor në të njëjtën kohë për të gjithë grupet e përdoruesve.

INSTAT-i në prodhimin e statistikave, udhëhiqet nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, të cilat shprehen në ligjin Nr.17, dt.05.04.2018, “Për statistikat zyrtare”, neni 4 siç janë: paanshmëria, besueshmëria, kosto efektiviteti, konfidencialiteti statistikor.

Për të siguruar cilësinë e prodhimit, statistikat zyrtare duhet të zhvillohen, të prodhohen dhe të shpërndahen mbi bazën e standardeve të unifikuara dhe metodologjive të harmonizuara, duke ndjekur këto kritere cilësie, (neni 5) si e drejta e hyrjes dhe qartësia, krahasueshmëria, koherenca, transparenca.

Nevoja për ruajtjen e privatësisë të të dhënave të grumbulluara dhe integriteti në të dhënat statistikore është një vendim që për INSTAT, nënkupton vendosjen e një bilanci ndërmjet të drejtës për privatësi dhe nevojës në rritje për informacion. Shprehur në Parimet e statistikave zyrtare, neni 4, pika d) “*Konfidencialiteti statistikor*” është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt ose indirekt për qëllime statistikore nga burime administrative ose të tjera. Ai nënkupton parandalimin e përdorimit për qëllime jostatistikore të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm të tyre.

INSTAT në punën e tij duhet të sigurojë besueshmëri në procesin e grumbullimit, prodhimit dhe shpërndarjes të të dhënave nga njësitë statistikore dhe për këtë zbaton me korrektësi parimet e sipërpërmendura të statistikave zyrtare.

Për të qenë sa më pranë përdoruesit, INSTAT zbaton politikat e tij mbi shpërndarjen e informacionit në nivel të grupuar apo në nivel individual. INSTAT, për prodhimin e statistikave zyrtare, grumbullon informacion nëpërmjet vërtetimeve statistikore (cens apo kampion) dhe burimeve administrative, sipas një periodiciteti të caktuar. Të dhënat mbledhen në nivel mikro (individ, familje, njësi ekonomike). **Me përkufizim të dhënat mikro nga vërtimet janë të dhëna të regjistruara në nivel të detajuar, mbi të cilat ndërtohen të dhënat e grupuara, ku çdo regjistrim përfaqëson një përgjigje (ose disa përgjigje) të pyetjeve të përfshira në një pyetsor të veçantë.** Të

dhënat sigurohen nga përgjigjet e individëve, familjeve dhe njësive ekonomike, në varësi të specifikës së vërtetimit të kryer. Ruajtja e anonimitetit të individit apo njësisë në hyrjen në të dhënat mikro është rreptësisht e detyrueshme. **Të dhënat mikro nga vërtetimet përdoren vetëm për qëllime kërkimore-shkencore.**

Objektivi kryesor i INSTAT në sigurimin e të drejtës për të dhëna mikro është të mbështesë komunitetin kërkimor-shkencor dhe të sigurojë hyrjen në të dhënat e mbledhura. Kjo e drejtë mbështet realizimin e këtij objekti në tre drejtime kryesore: i) drejt hartimit të politikave të bazuara në të dhëna, ii) ka potencialin për të ulur koston e kërkimit dhe gjithashtu iii) ndihmon për të shmangur grumbullimin e të dhënave të dyfishta.

Dy grupe të dhëna mikro identifikohen:

- 1) Të dhëna mikro të anonimizuara;
- 2) Të dhëna mikro të anonimizuara me të drejtë hyrje

I. Të dhëna mikro të anonimizuara

Në zbatim të Ligjit Nr. 17, datë 05.04.2018, “Për statistikën zyrtare”, INSTAT mund të sigurojë të drejtë hyrje në skedarët e të dhënave në nivel individual nën kushte të caktuara sigurie, për të siguruar që integriteti dhe konfidencialiteti i të dhënave të mbledhura është përmbushur nën zbatimin e akteve ligjore. INSTAT siguron akses për përdoruesin e gjerë në skedarët me të dhëna të anonimizuara. Këto skedarë përmbajnë të dhëna mikro që janë prodhuar për qëllime statistikore / kërkimore vetëm në një formë të tillë që informacioni individual lidhur me një njësi apo individ nuk është i identifikueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Aktualisht, INSTAT, në zbatim të nenit 31, “Konfidencialiteti”, të Ligjit 17, datë 05.04.2018, “Për Statistikën Zyrtare”, ka anonimizuar skedarë me të dhëna mikro lidhur me vërtetimet pranë familjeve, të arkivuar në linket përkatëse në faqen e web: <http://www.instat.gov.al/al/statistika/të-dhënat-mikro>;

Skedarët, aktualisht të publikuar nga INSTAT dhe të vlefshëm në arkivë, konsistojnë në të dhëna mikro të anonimizuara nga vërtetimi i kryer mbi Forcat e Punës, vërtetimi mbi Matjen e nivelit të jetesës, Migracioni dhe Census i Popullsisë dhe Banesave 2011.

- **Tregu i Punës** - Të dhënat e publikuara në nivel mikro i referohen:
 - të dhënave mikro të Anketës së Forcave të Punës, për periudhën 2007-2013, në program statistikor SPSS.
 - të dhënave të Anketës së Përdorimit të Kohës (2010-2011) në program statistikor SPSS, përmbajtja e Ditarit (në SPSS) dhe libri i kodeve për çdo fushë të kërkuar dhe përdorur në vërtetim në program excel.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Për më shumë informacion shiko:

- [http://www.instat.gov.al/al/statistika/të-dhënat-mikro/ Tregu i punës:](http://www.instat.gov.al/al/statistika/të-dhënat-mikro/Tregu_i_punës:)
- [Të dhënat mikro nga Anketa e Forcave të Punës 2007 - 2013 \(spss\) / Të dhënat mikro nga Anketa e Forcave të Punës 2007 - 2013 \(spss\);](#)
- [Anketa e Përdorimit të Kohës 2010-2011 \(spss\);](#)
- [Diary 2d+3d TUS Albania \(spss\);](#)
- [AL_TUS 2012-2011 \(excel codebook\).](#)

- **Niveli i Jetesës** - Të dhënat e publikuara në nivel mikro i referohen:
- të dhënave mikro të anketës mbi Matjen e nivelit të jetesës, 2002, 2005, 2008, 2012, në program statistikor SPSS.

Për më shumë informacion shiko:

- [http://www.instat.gov.al/al/statistika/të-dhënat-mikro/ Niveli i Jetesës:](http://www.instat.gov.al/al/statistika/të-dhënat-mikro/Niveli_i_Jetesës:)
- [Të dhënat mikro të anketës së matjes së nivelit të jetesës, 2002 \(spss\);](#)
- [Të dhënat mikro të anketës së matjes së nivelit të jetesës, 2005 \(spss\);](#)
- [Të dhënat mikro të anketës së matjes së nivelit të jetesës, 2008 \(spss\);](#)
- [Të dhënat mikro të anketës së matjes së nivelit të jetesës, 2012 \(spss\);](#)

- **Census i Popullsisë dhe Banesave** - Të dhënat e publikuara në nivel mikro i referohen:
 - të dhënave mikro të një kampioni të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga skedari i Censurit 2011;
 - metodologjisë të përgjithësimit të të dhënave të censusit mbështetur në kampionin e zgjedhur në mënyrë të rastësishme;

Për më shumë informacion shiko:

- [http://www.instat.gov.al/al/statistika/të-dhënat-mikro/CENSUSCensusi i popullsisë dhe Banesave 2011;](http://www.instat.gov.al/al/statistika/të-dhënat-mikro/CENSUSCensusi_i_popullsisë_dhe_Banesave_2011;)

- **Migracioni** - Të dhënat e publikuara në nivel mikro i referohen:
 - të dhënave mikro të anketës së Migracionit të kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri, në program statistikor SPSS.

Për më shumë informacion shiko:

- <http://www.instat.gov.al/al/statistika/të-dhënat-mikro/Migracioni>
- [*Të dhënat mikro të anketës së Migracionit të kthimit dhe ri-integrimit në Shqipëri \(spss\).*](#)

II. Të dhëna mikro të anonimizuara me të drejtë hyrje me kërkesë

Të dhëna mikro të anonimizuara me kërkesë janë skedarë me të dhëna në nivel njësie statistikore, të cilat nuk përmbajnë identifikues të drejtëpërdrejtë, por mund të mbajnë riskun për t'u identifikuar në mënyrë të tërthortë. Të dhënat mikro me kërkesë nuk janë produkte statistikore të publikueshme, ato përdoren vetëm për qëllime kërkimore-shkencore. Aksesit në këto të dhëna është i kontrolluar në mënyrë të rreptë dhe sipas kushteve të përcaktuara në ligjin Nr.17, dt.05.04.2018, “Për statistikatat zyrtare” dhe Rregullores mbi “E drejta për hyrje në të dhënat mikro”.

E drejta për hyrje në të dhënat mikro, konfidenciale për projekte kërkimore-shkencore, mund të jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it për një periudhë të kufizuar, duke siguruar se të dhënat nuk lejojnë identifikimin e drejtëpërdrejtë (referuar Ligjit për Statistikat zyrtare, neni 31, pika 7).

Për të mundësuar të drejtën për hyrje tek të dhënat mikro, çdo kërkues shkencor (punonjës apo jo i INSTAT, apo i një agjensie statistikore), institucion, organizatë duhet ti referohet kësaj rregulloreje dhe anekseve (1-4) që janë pjesë përbërëse të saj.

1. Rregullat mbi të drejtën e hyrjes në të dhënat mikro me kërkesë;
2. Proçedura e aplikimit për skedarët me të dhëna mikro me kërkesë;
3. Forma e aplikimit për skedarët me të dhëna mikro me kërkesë; (Aneks 1)
4. Deklarata e konfidencialitetit për punonjësit e statistikës (Aneks 2)
5. Deklarata e konfidencialitetit për kërkuesit (Aneks 3)
6. Kontratë ndërmjet palëve (Aneks 4)
7. Lista e vrojttimeve

Rregullat mbi të drejtën e hyrjes në të dhënat mikro me kërkesë

Informacion i përgjithshëm

Skedarët me të dhëna mikro me kërkesë janë skedarë me njësi të regjistruara, të prodhuara vetëm për qëllime kërkimore shkencore nga INSTAT, sipas neni 31, pika 5 “ *Të gjitha të dhënat mikro të mbledhura nga njësi statistikore për prodhimin e statistikave zyrtare përdoren vetëm për qëllime*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

statistikore. Këto të dhëna botohen vetëm bashkërisht dhe nuk përdoren për të marrë ndonjë vendim administrativ, duke përfshirë këtu vendime për kontrollin fiskal ose hetime juridike”, pika 7 “E drejta e hyrjes në të dhënat konfidenciale për projekte kërkimore-shkencore mund të jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it për një periudhë të kufizuar, duke siguruar se të dhënat nuk lejojnë identifikimin e drejtpërdrejtë. Marrësi duhet të nënshkruajë një kontratë me INSTAT-in, sipas së cilës:a) sigurohet se rezultati i parashikuar nuk u referohet njësive të identifikueshme ose nuk lejon identifikimin e tërthortë;b) sigurohet standardi i mbrojtjes së të dhënave konfidenciale, brenda projektit të kërkimit;c) ka një detyrim të zhdrukë menjëherë të dhënat, sapo projekti përfundon, duke njoftuar me shkrim INSTAT-in për këtë veprim” dhe pika 8 “Statistikat zyrtare nuk mund t'u jepen përdoruesve, duke zbuluar të dhëna konfidenciale”, të ligjit Nr.17, dt.05.04.2018, “Për statistikat zyrtare”. Procesi mbi autorizimin e të drejtës për hyrje në të dhënat mikro dhe për menaxhimin e projekteve kërkimore është i kontrolluar në mënyrë të rreptë nga INSTAT.

Të dhënat mikro nuk janë produkt statistikor. Produktet statistikore zyrtare janë publikimi i të dhënave të grupuara për çdo aktivitet statistikor që INSTAT kryen, si të tilla të dhënat mikro nuk janë të publikuara dhe nuk mund të bëhen të vlefshme për publikun e gjerë.

Baza ligjore

E drejta për hyrje në të dhënat mikro bëhet vetëm për qëllime kërkimore shkencore, bazuar në aktet ligjore si :

- ✓ [Ligji Nr. 17, datë 05.04.2018](#); neni 31 “Konfidencialiteti” dhe neni 38, pika b, “Kundërvajtjet administrative dhe gjokat”;
- ✓ [Vendimi i Kuvendit, Nr 10/2017](#), datë 09/02.2017, mbi zbatimin e “Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare, 2017-2021”;

INSTAT është i hapur dhe transparent në informacionin e publikuar mbi statistikat zyrtare, bazuar edhe në programin e transparencës dhe rregulloret mbi cilësinë e informacionit, referuar:

- ✓ Transparenca: [Programi i transparencës | INSTAT](#);
- ✓ Cilësia statistikore: [Cilësia statistikore | INSTAT](#)

INSTAT respekton dhe akte të tjera ligjore, në mbështetje të mbrojtjes së të dhënave personale dhe informimit publik, si:

- ✓ [Ligji 119/2014, “Për të drejtën e informimit”](#);
- ✓ [Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”](#), i ndryshuar;
- ✓ [Ligji Nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”](#).

Baza ligjore ndërkombëtare / evropiane:

UNECE/ statistical.confidentiality:

<http://www.unece.org/fileadmin/DAM/stats/publications/statistical.confidentiality.pdf>;

Eurostat / Statistical confidentiality:

<http://ec.europa.eu/eurostat/web/research-methodology/statistical-confidentiality>;

Procedura e aplikimit

Kërkesa për të marrë të drejtën për hyrje në të dhënat mikro duhet të bëhet duke plotësuar Formën e aplikimit (Aneks 1). Vendimi përfundimtar merret vetëm pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT.

Konfidencialiteti

INSTAT nënvizon se punonjësit e statistikës të caktuar për prodhimin e të dhënave mikro ligjërisht duhet të sigurojnë konfidencialitetin e të dhënave mikro. Ndërkohë, INSTAT ka të drejtë të kryejë çdo kontroll të duhur statistikor, ose përpara se e dhëna mikro ti kalojë kërkuesit, ose pas prodhimit të materialit nga kërkuesi. Ky proces do të zvogëlojë detyrimet e sipërpërmendura dhe cituara në ligjin për Statistikën, mbi Konfidencialitetin dhe Kundërvajtjet administrative.

Kriteret për të drejta për hyrje në të dhënat mikro

E drejta e hyrjes në të dhënat mikro për aktivitete të listuara është privilegj i të gjithë kërkuesve të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e vendosura nga INSTAT. Kërkesa zyrtare drejtuar INSTAT, duhet të përmbajë:

- a) Qëllimin e kërkimit;
- b) Shpjegimin përse ky qëllim nuk mund të plotësohet duke përdorur të dhënat e publikuara nga INSTAT në formë të grupuar;
- c) Njësia që kërkon të drejta hyrje;
- d) Kërkuesin individual i cili kërkon të ketë të drejta hyrje në të dhëna mikro;
- e) Lehtësirat e të drejtës për t'u përdorur nga kërkuesi;
- f) Skedarët e të dhënave që mund të përdoren në nivel individual;
- g) Metoda e analizës së të dhënave;
- h) Rezultatet e nxjerra nga studimi i kërkuesit nëse publikohen ose shpërndahen.

Grupet e caktuara me të drejtë hyrje:

E drejtë për hyrje në të dhënat mikro, në varësi të zbatimit të Ligjit për Statistikat dhe rregullat, e drejta për hyrje në të dhëna mikro, në përgjithësi, **do t'ju jepet vetëm**:

- a) Studiuesve të cilët, ose në të drejtën e tyre ose si punonjës të një organizate / institucioni kërkimor të njohur, kanë një evidencë të provuar në analizën e të dhënave ose në kërkim shkencor.
- b) Kërkuesve ose individëve që punojnë në organizata/institucione që mund të japin një arsye specifike të kërimit, i cili duhet t'i shërbejë drejtpërdrejt qëllimit të përmirësimit të produkteve statistikore zyrtare. E drejta e hyrjes në të dhëna jepet vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT;

Nuk mund tu jepet e drejtë për hyrje në të dhënat mikro:

- Individëve të cilët nuk janë pjesë e një organizate/institucioni sipas pikës (a) dhe (b);
- Individëve të cilët punojnë për një ndërmarrje ose janë pjesë e një ndërmarrje, e cila gjendet në skedarin e të dhënave mikro të ndërmarrjeve;
- Medias dhe organizatave ose institucioneve të lidhur me to.

Infrastruktura IT për të drejtën e hyrjes në të dhënat mikro

Të gjithë të drejtat për hyrje në të dhënat mikro, do të jenë të kontrolluara nga INSTAT. Aksesit në të dhëna mikro mund të jepet me të drejtë hyrje në INSTAT, në ambientin e sigurt, pranë Qendrës Statistikore të Trajnimit, të ndërtuar për këtë qëllim, pranë INSTAT.

Për të dhënat e ofruara sigurohet e drejtë hyrje vetëm në INSTAT dhe pa të drejtë shpërndarje. Në kompjuterin e vendosur në ambientin e sigurt, pranë Qendrës Statistikore të Trajnimit në INSTAT, do të instalohen programe aplikative të ndryshme për përpunimin e të dhënave dhe për analiza të thjeshta. Kriteret për përcaktimin e tipit të të drejtës për hyrje do të përfshijnë:

- a) Sigurinë dhe përshtatshmërinë e mjedisit të punës të studiuesit;
- b) Bashkëpunimi i studiuesit me një organizatë / institucion të njohur që ka një histori të provuar në analizën e të dhënave ose kërkimin;
- c) Rreziku i identifikimit të tërthortë të të dhënave të përfshira në skedarin me të dhëna mikro;

Të dhëna mikro me kërkesë dhe e drejta për hyrje në të dhënat mikro

Për realizimin e kërkesës, fillimisht kërkohet takim me Sektorin e Publikimeve dhe shpërndarjes së informacionit në INSTAT, për paraqitjen e kërkesës dhe për të bërë të njohur kushtet e kontratës, mbi të drejtën për kërkim apo hyrje në të dhënat mikro.

E drejta për të dhëna mikro nga studentët, lejohet vetëm nga ata që janë për studime post-master dhe në të gjitha këto raste edhe udhëheqësi i studimit duhet të aplikojë ose të kryejë takimin përkatës me Sektorin e Publikimeve dhe shpërndarjes së informacionit, përpara se të miratohet e drejta e dhënies apo hyrjes në të dhënat mikro.

E drejta për hyrje në të dhënat mikro do t'u jepet kërkuesve të cilët:

- Kanë plotësuar formularin e aplikimit;
- Kanë kryer takimin me sektorin e publikimeve dhe shpërndarjes së informacionit;
- Kanë marrë aprovimin;
- Zyrtarisht kanë dakordësuar me kushtet standarte të Kontratës ndërmjet palëve;
- Kanë nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit;

INSTAT, mban të regjistruar të gjithë kërkesat individuale ose institucionale, për të drejtë hyrje në të dhënat mikro.

E drejta për hyrje në të dhënat nga burimet administrative do të jetë e kufizuar, e drejta do të jetë vetëm për të dhëna për një kampion të caktuar, në masën 3 % dhe mund të jenë subjekt i kushteve shtesë të kontratës të përcaktuar nga INSTAT. Në përgjithësi, e drejta për hyrje në të dhënat mikro që lidhen me vërtetimet e njësive ekonomike dhe familjare, dhe të dhënave administrative (me kampion) do të lejohet vetëm në vend (në ambientet e INSTAT).

Siguria në ambientin e INSTAT

Në lidhje me të drejtën për hyrje në ambientet e INSTAT:

- a) Vetëm ata persona të cilët janë të caktuar nga INSTAT mund të përdorin shërbimin e të drejtës së hyrjes në ambientin e sigurt në INSTAT;
- b) Shërbimi i dhënies së të drejtës duhet të realizohet vetëm nga një vend i sigurt siç është ambienti i krijuar për këtë qëllim në INSTAT, pranë QST;
- c) INSTAT rezervon të drejtën për të kontrolluar kërkuesin shkencor gjatë punës në ambientin e sigurt pranë INSTAT, pa njoftim paraprak, për të siguruar që janë vendosur procedurat e duhura për të mbrojtur konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave;
- d) Studiuesi duhet të sigurohet që e drejta për hyrje në çdo kohë është e kufizuar. Kjo përfshin sigurimin që sistemi të mos punojë kur nuk është në hyrje dhe të dhënat të mund të mos të shihen nga dikush tjetër përveç punonjësit të INSTAT të caktuar për këtë qëllim;

- e) Regjistrimi, kopjimi ose përpjekja për të transferuar të dhëna në çdo format nga kompjuteri i caktuar për këtë qëllim është rreptësisht e ndaluar.

Mbrojtja e produktit statistikor

Përgjegjësia për sigurimin e konfidencialitetit të të gjitha rezultateve (raporte, publikime, prezantime, artikuj, etj.) bazuar në kërkesën e kryer për të drejta për hyrje në të dhënat mikro, qëndron tek individi i cili është punonjës i statistikës që ka prodhuar informacionin. Kufizimet dhe ndalimet për identifikimin e informacionit janë të përcaktuara në nenin 31, të Ligjit “Për Statistikat zyrtare”, Nr. 17, dt. 05.04.2018. Punonjësi i statistikës do të rishikojë të dhënat e prodhuara, për të kontrolluar nëse ato nuk janë konfidenciale në natyrën e tyre, duke siguruar edhe vendosjen e kodit statistikor i cili nuk identifikon njësinë origjinale. Këto duhet të vlerësohen në kontekstin e të gjithë informacioneve të disponueshme nga INSTAT, për të mbrojtur identifikimin përmes krahasimit të burimeve të ndryshme të informacionit.

Në përfundim të projektit, të gjitha rezultatet nga projekti kërkimor shkencor duhet t'i ofrohen INSTAT-it për qëllime informimi. Nëse kërkohet nga INSTAT (e specifikuar në Kontratë), të gjitha rezultatet (raportet, publikimet, prezantimet, artikujt etj.) duhet të dorëzohen pranë institucionit për miratim, para se të publikohen, në mënyrë që të sigurohet respektimi i ligjit për Statistikat dhe materialet e tjera informuese për këtë qëllim. INSTAT rezervon të drejtën për të nxjerrë rezultatet nga kërkimi shkencor në publikim, nëse specialisti i statistikës, prodhues i këtij informacioni zyrtarisht, nuk i ka konfirmuar rezultatet të cilat përkojnë me ato statistika zyrtare të publikuara.

Të dhënat mikro, pavarësisht ndonjë ndryshimi që mund ti ketë bërë studiuesi gjatë analizës, mbeten pronë e INSTAT. Analiza apo kërkimi i kryer duhet të përputhet ose të jetë në përputhje me qëllimin specifik për të cilin i është dhënë e drejta për hyrje tek të dhënat mikro. Të gjithë skedarët të cilët lidhen nga burime të ndryshme në INSTAT, përgatiten vetëm në rast se kërkohet sipas kërkesës zyrtare apo kontratës për të drejtë hyrje në të dhënat mikro, të nënshkruar, dhe i nënshtrohet rregullave të konfidencialitetit dhe kushteve të cilat zbatohen për skedarin origjinal (nga një burim i vetëm). Pas përfundimit të kërkimit e drejta për hyrje në të dhënat mikro përfundon.

Kontrolli

Përveç masave mbrojtëse të prodhimit të përshkruar më sipër, sesionet e analizave mund të regjistrohen nga stafi i INSTAT, për të siguruar që rregullat e institucionit për dhënien e të drejtës për hyrje në të dhënat mikro është respektuar plotësisht.

Mirënjohje

INSTAT duhet të pranohet si burim i të dhënave në të gjitha rezultatet, duke përfshirë citimin në tabelat dhe analizat e grupuara bazuar në treguesit e nxjerrë. Citimi vijues duhet të përfshihet në të gjitha botimet: "Rezultatet bazohen në analizën e të dhënave mikro të kontrolluara rreptësisht nga INSTAT. INSTAT nuk merr asnjë përgjegjësi për pikëpamjet e shprehura apo rezultatet e krijuara nga ky kërkim".

Sanksionet

Mosrespektimi i termave dhe kushteve të përcaktuara në kontratën e nënshkruar mund të ketë implikime për individin dhe organizatën / institutin për të cilin ata punojnë. Këto sanksione mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- a) Kërkesa për kthim dhe / ose ndërprerjen e hyrjes tek të gjitha informacionet e ofruara nga INSTAT, në rastin e mosrespektimit të kriterëve dhe kushteve të marrëveshjes për të drejtë hyrje në të dhëna mikro apo deklaratës së konfidencialitetit;
- b) Refuzimi i kërkesave të ardhshme për të drejtë hyrje tek të dhëna mikro;

Minimizimi i të dhënave

Në rastet kur është e realizueshme, kërkesat e të dhënave mikro do të përmbushen nëpërmjet sigurimit të të dhënave të grupuara (ose në skedarë të anonimizuar), të ndryshme nga skedarët me të dhëna mikro. Kjo për të minimizuar të drejtën për hyrje tek të dhëna mikro, duke respektuar qëllimin e kërimit. D.m.th informacioni i dhënë kërkuar shpesh do të jetë i kufizuar në ato ndryshore (variabla) të cilat janë të nevojshme për kërkimin specifik statistikor. Është rreptësisht e ndaluar dhënia e numrit origjinal të identifikimit, qoftë edhe për kërkime shkencore.

Procedura e aplikimit për skedarët me të dhëna mikro me kërkesë

Të gjitha kërkesat për të dhëna bëhen duke plotësuar formularin kërkesë të vendosur në faqen web të INSTAT, për referencë linku:

<http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/kërkesë-të-dhënash>.

Të gjitha kërkesat për të dhëna mikro bëhen duke plotësuar formularin e aplikimit të vendosur në faqen web të INSTAT, për referencë linku: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/>

Hapat që ndiqen:

INSTAT do të marrë në konsideratë vetëm ato formularë të cilët do të jenë të plotësuar në rregull dhe konform kërkesës, dhe nuk do të marrë në konsideratë të gjithë ato formularë të cilat do të kenë mangësi në plotësim. Në rast se janë shumë kërkuar për një qëllim projekti, do të referohet vendosja e një përfaqësuesi.

Pas plotësimit të formës së shfaqur në web, kërkuar krijon kontakt me sektorin përkatës të Publikimit dhe Shpërndarjes së Informacionit. Sektori në fjalë mban të regjistruar me numër reference, të gjithë kërkesat për të dhëna mikro, si psh. Kërkesa e parë, më datë....., mbi..... Ky informacion ruhet pranë SPSHI.

Sektori PSHI krijon lidhjen ndërmjet kërkuar dhe siguruesit të të dhënave, për sqarime teknike më të hollësishme. Duhet mbajtur në vëmendje se përgjegjësinë për mos ruajtjen e konfidencialitetit e mban sektori i cili ka përgatitur të dhënat mikro dhe sektori i cili menaxhon ruajtjen në institucion (në rastin e hyrjes) dhe mënyrën e transmetimit, në rastin e kërimit, sipas rregullores mbi “Rregullore mbi të drejtën e hyrjes në të dhënat mikro”.

Specialisti i statistikës e diskuton kërkesën me drejtorin e drejtorisë dhe bën komentet përkatëse. Nëse specialisti i statistikës merr përsipër përmbushjen e kërkesës, ai firmos në Formën e aplikimit, pas miratimit, Aneksi 3, si dhe për ruajtjen e konfidencialitetit në plotësim të kërkesës, mbetet në fuqi Deklarata e konfidencialitetit (Aneksi 5). Në rast refuzimi të kërkesës njoftohet sektori i PSHI dhe për dijeni Drejtori i Përgjithshëm dhe aplikanti.

Pas miratimit nga specialisti i statistikës të kërkesës, Drejtori i drejtorisë diskuton kërkesën me Drejtorin e Përgjithshëm, në rast pranimi të kërkesës, jepen të gjitha shpjegimet në përmbushje të “Rregullore mbi të drejtën e hyrjes në të dhënat mikro” dhe firmosen dokumentet përkatëse (si deklarata e konfidencialitetit dhe kontrata) dhe në rast refuzimi jepen arsyet përkatëse dhe njoftohet aplikanti.

Në rastin kur kërkuar është përfaqësues i një institucioni, (institucione jo-qeveritare, ministri, institucione në varësi të ministrive), (sipas pika “b” Grupet e caktuara me të drejtë hyrje), mund ti jepet e drejtë vetëm pas dhënies së një arsyetimi të qartë dhe specifik të kërimit, të pranueshme nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT.

Aneks 1 - Forma e aplikimit për skedarët me të dhëna mikro

Seksioni 1 – Informacion përmbledhës

Kjo formë aplikimi duhet të përfshijë emrin, informacione të tjera të detajuara, të të gjithë kërkuessve që do të jenë të përfshirë në kërkesë.

Të dhënat e detajuara

Aplikanti 1:

Emri: _____

Institucioni /Organizata: _____

Adresa: _____

Pozicioni në institucion/organizatë: _____

Adresa e-mail: _____

Telefon: _____

Aplikanti 2:

Emri: _____

Organizata: _____

Adresa: _____

Pozicioni në institucion /organizatë: _____

Adresa e-mail: _____

Telefon: _____

Seksioni 2 – Aplikimi vetëm për studentë

Studentët duhet të sigurojnë informacion të detajuar për udhëheqësin e temës së tyre, kontaktet e detajuara. (Informacioni mbi të dhënat mikro është i lejuar vetëm për student për post-master) ose punonjës statistike për të njëjtin qëllim.

Emri i udhëheqësit: _____

Institucioni: _____

Adresa e plotë: _____

Email i udhëheqësit: _____

Seksioni 3 – Eksperienca kërkimore e aplikantit dhe institucioni/organizata mbështetëse

Lutem plotësimin për çdo aplikant!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

1. Lutem shënoni eksperiencat në kërkime/analiza (duke shpjeguar me detaje eksperiencat në punën me të dhëna mikro):

--

2. Lutem shënoni eksperiencat në publikime, artikuj, etj që ju keni shkruajtur apo publikuar:

--

3. Lutem shënoni qëllimin /aktivitetin kryesor të institucionit/organizatës për të cilin ju punoni:

--

4. Nëse institucioni/organizata juaj ka një njësi të dedikuar për kërkime lutem jepni informacion të detajuar mbi (madhësinë, fushën e kërkimit, etj):

--

Seksioni 4 – Të dhëna specifike të detajuara

1. Për çfarë të dhënash mikro jeni të interesuar (Sociale, Ekonomike, etj)?

--

2. Lutem specifikoni gjatësinë e kohës që ju kërkoni të keni të drejtë hyrje (psh, një muaj, tre muaj)?

--

3. Lutem specifikoni serinë kohore të të dhënave që kërkoni? (psh 2010-2015)?

--

4. Lutem jepni informacion të detajuar mbi kërkimin e propozuar për të cilat kërkohet aksesimi , duke përfshirë një skicë të objektivave / synimeve kryesore të kërkimit të propozuar :

5. Ju jeni duke bërë kërkime në emër tuaj (duke përfshirë atë të organizatës suaj)?

Po ☐

Jo ☐

6. Nëse jo, kush është autoriteti kontraktues?

7. Lutemi jepni detajet e kontaktit në kuadër të autoritetit kontraktues:

Emër: _____

Adresa e plotë e institucionit/organizatës: _____

Pozicioni: _____

Email: _____

Telefoni: _____

8. Pse aksesimi për hyrje tek të dhënat mikro me kërkesë është i nevojshëm për këtë projekt?

(shpjegoni përse të dhënat e grupuara nuk mund të përdoren)

9. Lutem identifikoni auditorin e synuar për rezultatet e propozuara / parashikuara:

10. A është propozuar të publikohen rezultatet e kërkimit tuaj?

Po ☐

Jo ☐

Komento (Nëse e shikoni të përshtatshme):



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

11. Lutem detaje të rezultatit/rezultateve (si psh raporte, artikuj, libra, etj) nga ky kërkim:

12. Në lidhje me tabelat e rezultateve, lutem përshkruani kriteret që do të përdorni për të përcaktuar nëse të dhënat e grumbulluara janë të zbuluara (të identifikuara) apo jo?

13. Ka ndonjë burim tjetër të dhënash për kërkimin e propozuar?

14. Në qoftëse po, përse i kërkoni të dhënat mikro?

15. Keni studime të ngjashme / projekte në lidhje me këtë temë më parë? Nëse po, lutem përshkruani:

16. A do të përdoren të dhënat mikro që kërkoni për të nxjerrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çdo përfitim monetar / përfitim për ju personalisht ose për organizatën për të cilën ju po kryeni studimin?

Po ☐

Jo ☐

Nëse Po, lutem përshkruani:

Seksioni 5 – Detaje specifike në lidhje me kërkesat për të dhëna mikro vetëm për ndërmarrjet

1. Keni ju ose institucioni/organizata për të cilin po kryeni studimin lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me një prej ndërmarjeve ose grup ndërmarrje, të cilat mund të jenë pjesë e skedarit me të dhëna mikro që ju po kërkoni?

Nëse Po, lutem përshkruani:

Seksioni 6 – Detaje specifike në lidhje me kërkesën tuaj për të punuar në një kompjuter në INSTAT

1. Kur e drejta për të dhëna ju jepet për të punuar në INSTAT, lutem jepni informacion mbi aplikacionin e IT në të cilin ju propozoni, për të përdorur për analizat e studimit tuaj:

Deklaratë

Nënshkrim për konfirmim të informacionit të plotësuar në këtë formë aplikimi është korrekt:

Nënshkrimi:_____ Data:_____ Organizata:_____

Nënshkrimi:_____ Data:_____ Organizata:_____

Nënshkrimi:_____ Data:_____ Organizata:_____

Rekomanduar nga (specialisti i statistikës): _____

Ju lutem në vëmendjen tuaj se çdo referencë për nënshkrimin dhe datën në këtë dokument mund të lexohet si kuptim i emrit dhe datës së shtypur, kur një aplikim i tillë pranohet në mënyrë elektronike.

Seksioni 7 – Aprovimi për hyrje në të dhëna mikro

Nënshkrimi : _____ Data: _____ Organizata: INSTAT

Seksioni 8 – Arsyet për mosaprovim për hyrje në të dhëna mikro

Aneks 2 - Deklaratë konfidencialiteti për punonjësit e INSTAT

DEKLARATË KONFIDENCIALITETI

Objekti

Kjo deklaratë i drejtohet INSTAT-it nga nëpunësi i këtij institucioni, që ka akses në të dhënat e **INSTITUTIT TË STATISTIKAVE**.

Qëllimi

Kjo deklaratë nënshkruhet nga të gjithë individët të cilët kanë akses në të dhënat e INSTAT-it. Deklarata përcakton kërkesat dhe përgjegjësitë e atyre që kanë akses në informacione të tilla dhe siguron që të gjitha palët e interesuara të kuptojnë detyrimet e tyre të konfidencialitetit.

Fusha e veprimit

Fushë veprimi e kësaj deklarate shtrihet për të gjitha të dhënat dhe informacionet konfidenciale që njihen gjatë punës në INSTAT. Dispozitat përkatëse zbatohen, pavarësisht faktit nëse Deklaruesi vazhdon të jetë në marrëdhënie pune ose jo me INSTAT-in.

Deklarata e konfidencialitetit

Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdor dhe të mos u transmetoj personave të paaautorizuar të dhëna apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga **INSTAT**, përveç rastit kur autorizohem shprehimisht nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it, ose kur kërkohet me ligj. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen si gjatë afatit të mbledhjes të të dhënave, ashtu dhe pas përfundimit të tij.

Unë e kuptoj se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave trajtohet nga Ligji nr. 17, datë 5.4.2018 "Për statistikat zyrtare", Ligji nr. 9987, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Unë nuk do të përdor ose përhap asnjë të dhënë që marr dijeni gjatë punës time për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.

Unë e kuptoj se jam i detyruar të ruaj konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t'i mbaj ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.

Unë deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se do të mbaj çdo informacion apo të dhënë personale për të cilat jam vënë në dijeni gjatë ushtrimit të funksionit pranë INSTAT-it, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës me INSTAT-in.

Unë marr pësipër përgjegjësinë e plotë që në qoftë se, konstatohet se kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme. Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të ruajtur imazhin e institucionit dhe respektuar të drejtat themelore të individëve, për sa i takon parimit të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale.

Emri, atësia, mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Pozicioni: _____

Drejtoria/Spektori: _____

Aneks 3 – Deklaratë konfidencialiteti për përdoruesit

DEKLARATË KONFIDENCIALITETI PËR PËRDORUESIT

Unë i/e nënshkruari/a, në cilësinë e _____ nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se pranoj të marr pësipër të mos përdor dhe të mos u transmetoj personave të paaautorizuar të dhëna apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga **INSTAT**, në kuadër të projektit të kërkimit, titulli i projektit _____, emërtimi i skedarit të kërkuar, _____, përveç rastit kur autorizohem shprehimisht nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it.

1. Duke nënshkruar këtë deklaratë, deklaroj se jam në dijeni se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave trajtohet nga Ligji nr. 17, datë 5.4.2018 "Për statistikat zyrtare", Ligji nr. 9987, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Unë nuk do të përdor ose përhap asnjë të dhënë që marr dijeni gjatë punës time për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.
2. Unë deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se jam i detyruar të ruaj konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t'i mbaj ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen si gjatë afatit të projektit të kërkimit, ashtu dhe pas përfundimit të tij.
3. Unë marr pësipër përgjegjësinë e plotë që në qoftë se, konstatohet se kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave apo në rast të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme. Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të ruajtur imazhin e institucionit dhe respektuar të drejtat themelore të individëve, për sa i takon parimit të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale.

4. Unë e kuptoj se kam detyrim të zhduk menjëherë çdo informacion apo të dhënë personale për të cilat jam vënë në dijeni sapo projekti përfundon, duke njoftuar me shkrim INSTAT-in për këtë veprim.
5. Unë e kuptoj se moszbatimi ose shkelja e kërkesave të konfidencialitetit, të përcaktuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 17, datë 5.4.2018 për “Statistikat Zyrtare”, përbën kundërvajtje administrative sipas përcaktimit të nenit 38, shkronja b) dhe dënohet me gjobë nga 20 000 lekë deri në 30 000 lekë.

Për: _____

Emër Mbiemër: _____

Nënshkrimi: _____

Pozicioni: _____

Aneks 4 - Kontratë ndërmjet palëve

KONTRATË

1. Palët:

INSTITUTI I STATISTIKAVE me adresë në Blv: Zhan D’Ark, Nr. 3, Tirana, Albania
në vijim referuar si “INSTAT” dhe
“Kërkuesi shkencor” _____
në vijim referuar si _____

2. Baza ligjore:

Ligji Nr. 17, datë 5.4.2018 për “Statistikat Zyrtare”
Ligji nr. 9987, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar

3. Qëllimi

Vënia në dispozicion e të dhënave sipas kërkesës së aprovuar nr. Prot. datë _____ në kuadër të projektit kërkimor _____.

4. Përgjegjësitë e palëve:

4.1 Për INSTAT:

- i) Për të realizuar objektin e kësaj marrëveshje INSTAT merr përsipër të vërë në dispozicion të kërkuesit shkencor të dhënat _____.
- ii) Krijimi i kushteve teknike për aksesin në të dhëna.
- iii) Aksesin në të dhëna do bëhet vetëm nëpërmjet kompjuterave të INSTAT në ambientin e sigurt, të krijuar.
- iv)

4.2 Për _____

Për të realizuar objektin e kësaj kontrate _____ marr përsipër:

- a. të përdor të dhënat vetëm për realizimin e projektit kërkimor shkencor _____.
- b. rezultati i parashikuar nuk u referohet njërive të identifikueshme ose nuk lejon identifikimin e tërthortë;
- c. Sigurohet standardi i mbrojtjes së të dhënave konfidenciale, brenda projektit të kërkimit;
- d. kam detyrimin të zhduk menjëherë të dhënat, sapo projekti përfundon, duke njoftuar me shkrim INSTAT-in për këtë veprim.

5. Afati:

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë _____ nga momenti i firmosjes së saj nga të dyja palët.

6. Sanksionet

Mosrespektimi i termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë kontratë parashikon sanksione të cilat mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- i. Kërkesa për kthim dhe / ose ndërprerjen e hyrjes tek të gjitha informacionet e ofruara nga INSTAT, në rastin e mosrespektimit të kriterëve dhe kushteve të marrëveshjes për të drejtë hyrje në të dhënat mikro, apo deklaratës së konfidencialitetit;
- ii. refuzim i kërkesave të ardhshme për të drejtë hyrje tek të dhënat mikro;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

7. Të tjera

Kjo marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë.

PËR

PËR

INSTITUTIN E STATISTIKAVE
DELINA IBRAHIMAJ

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Data e nënshkrimit

Data e nënshkrimit

Lista e Vrojtimeve

I. LISTA E VROJTIMEVE

1. Anketa Strukturore Pranë Ndërmarrjeve
2. Anketa e Buxhetit të Familjes